

**RREGULLORE NR. 2002/19**

UNMIK/RREG/2002/19

31 tetor 2002

**LIDHUR ME SHPALLJENE LIGJIT MBI ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM NË KOSOVË TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 18 tetor 2002 lidhur me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës më 26 shtator 2002,

Duke tërhequr vëmendjen në Urdhëresën administrative nr. MASHT 10/2002 të datës 20 gusht 2002 të nxjerrë nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vënie në jetë të nenit 11 për propozimin me konsensus të miratuar nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës dhe nga Kuvendi i Kosovës,

Me anë të kësaj shpall të plotfuqishëm ligjin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26 shtator 2002 i cili hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij dhe i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje (Ligji nr. 2002/2).

Nënshkruar sot, më 31 tetor 2002.

***Michael Steiner,***  
***Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm***

# INSTITUCIONET E PERKOHSHME TE VETQEVERISJES

## KUVENDI I KOSOVES

### LIGJI NR. 2002/2

#### **MBI ARSIMIN FILLOR DHE TË MESËM NË KOSOVË**

Në Pajtim me autoritetin që i është dhënë me Rregulloren e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 2001/9 të datës 15 Maj, 2001 “mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme”, neni 9.1.34-45 dhe Rregulloren nr. 2001/19 të UNMIK -ut të datës 13 shtator 2001 për Pushtetin Ekzekutiv të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Rregulloren nr. 2000/11 të UNMIK -ut të datës 3 mars 2000 për krijimin e Departamentit Administrativ të Arsimit dhe Shkencës, Rregulloren nr. 2000/45 të UNMIK -ut të datës 1 gusht 2000 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, Rregulloren nr. 2000/51 të UNMIK -ut të datës 30 gusht 2000 për moshën e shkollimit të detyruar në Kosovë,

Në pajtim me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolet e saj, Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare, si dhe parimet e tjera përkatëse të pasqyruara në instrumentet ligjore të njohura në shkallë ndërkombëtare;

Me qëllim që të vendosen rregullat ligjore në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë.

Të shpall Ligjin e mëposhtëm:

## KAPITULLI I: NENE TË PËRGJITHSHME

Neni 1

### PËRKUFIZIME

Në këtë Ligj emërtimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- (a) “Zona e mbulimit”, do të thotë zona e banimit e përcaktuar nga komuna për një institucion arsimor.
- (b) “Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (shkurt “MASHT”)”, do të thotë struktura përkatëse qeveritare, përgjegjësitë e së cilës mbulojnë fushën e arsimit, të shkencës dhe të teknologjisë.
- (c) “Kryenëpunësi Ekzekutiv”, do të thotë Kryenëpunësi Ekzekutiv i një komune siç përcaktohet në Nenin 30 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, ose personi që mbulon aktualisht funksionet e kësaj zyre.
- (d) “Fëmijë”, do të thotë çdo person nën moshën 18 vjeç.
- (e) “Moshë e shkollimit të detyruar” të një nxënësi do të thotë periudha e përkufizuar në nenin 7 të këtij Ligji.
- (f) “Programi bazë mësimor”, do të thotë ajo pjesë e përbashkët e programit mësimor e përcaktuar nga MASHT për të gjitha shkollat e financuara me fonde publike.
- (g) “Ndëshkimi fizik”, do të thotë çdo formë e goditjes ose kontakti tjetër fizik jo rastësishme e mësuesit ose një anëtar tjetër të personelit me një nxënë, me përjashtim të rasteve të ndërhyrjes së detyrueshme kur një nxënë rrezikon sigurinë e nxënësve të tjerë ose të personelit.
- (h) “Drejtori”, do të thotë drejtori i një institucioni arsimor i financuar me fonde publike.
- (i) “Institucioni arsimor”, do të thotë çdo shkollë ose institucion formues i cili realizon arsimin e niveleve 0, 1, 2, ose 3 sipas SNKA.
- (j) “Shërbim arsimor”, do të thotë çdo veprimtari që është drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e lidhur me mësimdhënien si dhe çdo mbështetje materiale apo ndonjë formë tjetër për arsimin parashkollor, fillor, ose të mesëm.
- (k) “ISCED” do të thotë Klasifikimi i Standardeve ndërkombëtare të Arsimit 1997 i miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO në sesionin e 29-të të saj në Nëntor 1997, si dhe përkufizimet përkatëse, të cilat tregohen në Shtojcën 1 të këtij Ligji.
- (l) “Drejtori i Arsimit të Komunës” do të thotë zyrtari në komunë me këtë emërtim ose personi që kryen këto funksione aktualisht.
- (m) “Shkolla komunale”, do të thotë çdo shkollë e financuar me fonde publike që themelohet në komunë.

- (n) “Prind”, do të thotë personi që ka kujdesje ligjore për fëmijën në bazë të ligjit përkatës.
- (o) Institucioni publik arsimor paraqet shkollën ose organizatën edukative-arsimore e cila financohet nga fondet publike.
- (p) “Nxënës” është çdo person i regjistruar në çfardo programi për arsimin fillor ose të mesëm
- (q) “Shkollë”, do të thotë çdo institucion arsimor që ofron shërbime arsimore në nivelet ISCED 0,1,2 dhe 3.
- (r) “Program mësimor i bazuar i shkollës”, do të thotë ajo pjesë e programit mësimor që përcaktohet nga vetë shkollat.
- (s) “Viti shkollor”, do të thotë periudha kohore që fillon në shtator të një viti dhe që përfundon më 31 gusht të vitit pasardhës. Ministria përcakton datat e sakta të vitit shkollor, i cili zhvillohet brenda një periudhe kohore të përbërë nga 45 javë të njëpasnjëshme.
- (t) “Arsimi i mesëm” i referohet arsimit të ulët ashtu dhe atij të lartë nëse nuk është specifikuar ndryshe.
- (u) “Zyrtar i Lartë i Arsimit”, do të thotë zyrtari i lartë arsimit i MASHT i dërguar pranë një komune ose më tepër ose personi që kryen aktualisht këto funksione.
- (v) “Arsim special”, do të thotë arsim për nxënësit me vështirësi në të mësuar dhe që kanë nevojë për arsimim të veçantë.
- (w) “Këshilli për shqyrtimin e aftësisë të arsimtarëve”, do të thotë struktura me këtë emër ose me një emër tjetër i formuluar nga MASHT me kompetencën për të miratuar kualifikimin, rikualifikimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve.
- (x) “Këshilli i Ekspertëve i Programeve dhe Teksteve Shkollore”, do të thotë struktura me këtë emër ose me një emër tjetër i krijuar nga MASHT me kompetencën për t’i bërë rekomandime Ministrisë lidhur me miratimin e planprogrameve, teksteve shkollore dhe materialeve të ngjashme që përdoren në institucionet arsimore.
- (y) “Institucioni i aftësisë”, do të thotë çdo institucion, përveç shkollës, i financuar me fonde publike i cili ofron shërbime arsimore të nivelit SNKA 3.
- (z) “Arsimi profesional”, do të thotë arsimi në nivelet 3 dhe 4 të SNKA i lidhur drejtpërsëdrejti me përgatitjen e individëve për punësim me pagesë ose pa pagesë ose pagesa vetëpunësim. Ai mund të kryhet brenda shërbimeve arsimore, brenda marrveshjeve të përcaktuara në vendët e punës ose në shtëpi.

## Neni 2

### FUSHA E VEPRIMIT TË KËTJLIGJI

#### 2.1 Ky Ligj:

- (a) Ka të bëjë me arsimin publik dhe privat; fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në shkolla dhe institucione të aftësisimit në Kosovë, me përjashtim të rasteve kur rregullohen në mënyrë të veçant specifiku; dhe
- (b) Përban dispozitën ndihmëse për arsimin parashkollor.

2.2 MASHT do të paraqesë propozime jo më vonë se 31 dhjetor 2003 për krijimin e sistemit pas shkollës së mesme, jo terciar në Kosovë dhe forma tjera për arsimin e të rriturve (SNKA niveli 4), si dhe propozime jo më vonë se më 1 tetor 2004 për zhvillimin e arsimit parashkollor (SNKA niveli 0).

2.3 Deri në zhvillimin e një politike mbarë kosovare për arsimin parashkollor, mundësia për realizimin e arsimit të nivelit 0 (arsimi parashkollor) është kompetencë e komunës në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- (a) Ndjekja e arsimit parashkollor është mbi baza vullnetare dhe komuna mund të kufizojë nivelin e përfshirjes për arësye ekonomike. Komuna është e lirë të vendosë dhe të bëjë përjashtime për pagesa për regjistrim, transportin në shkollë, ushqimin dhe çdo shërbim tjetër lidhur me dispozitën e arsimit parashkollor; dhe
- (b) Kohëzgjatja, orët, programi dhe çështje të tjera lidhur me arsimin parashkollor rregullohen nga MASHT.

## Neni 3

### E DREJTA PËR ARSIM

3.1 Është detyra e përgjithshme e MASHT që, në bazë të dispozitave të këtij Ligji dhe ligjit përkatës, të nxitë arsimimin e njerëzve në Kosovë dhe të kanë një program të përshtatshëm dhe të efektshëm të arsimit fillor dhe të mesëm, të pranueshëm për të gjithë.

3.2 Të gjithë fëmijëve u sigurohet e drejta për arsim. Kjo e drejtë realizohet mbi bazën e parimeve të mëposhtme:

- (a) Shkollimi në institucionet arsimore me fonde publike të nivelit 1, 2 dhe 3 është falas;
- (b) Tekstet mësimore në shkollat e nivelit të parë janë falas, ndërsa për nivelin e dytë dhe të tretë i ndanë Qeveria nëse ka mjete financiare.
- (c) Çdo fëmijë ka të drejtë të mësojë në gjuhën e tij apo të saj amtare në shkollën fillore e të mesme nëse plotësohen kushtet e parapara nga Ministria.

3.3 Ministria mund të nxjerrë udhëzime, me anë të të cilave u kërkon nxënësve të nivelit 3 të sigurojnë vetë materialet dhe pajisjet mësimore për kursin që ndjekin, si dhe të paguajnë

një tarifë standarde për dhënien e provimeve publike. Në udhëzimet përkatëse përcaktohen rastet kur nxënësit i njihet e drejta të mos e paguajë këtë tarifë dhe të marrë materiale falas.

3.4 Në ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të tyre të përcaktuara në këtë Ligj, MASHT dhe komunat respektojnë të drejtën e prindërve për sigurimin e arsimit dhe mësimdhënies në përputhje me normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Neni 4

#### **QËLLIMET E ARSIMIT**

4.1 Qëllimet e programit për arsimin fillor dhe të mesëm janë:

- (a) Të zhvillojë personalitetin, talentin dhe potencialin e plotë të aftësive mendore dhe fizike të nxënësit;
- (b) Të zhvillojë te nxënësi ndjenjën e respektit e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe të parimeve të shprehura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- (c) Të zhvillojë te nxënësi ndjenjën e respektit për prindërit dhe mësuesit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e kombit të tij, për vlerat e Kosovës dhe të komuniteteve të saj, dhe për qytetërimet e tjera që janë të ndryshme nga qytetërimi i tij;
- (d) Të përgatisë nxënësin për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, të paqes, të tolerancës, të barazisë gjinore, dhe të miqësisë midis të gjithë popujve, grupeve etnike, kombëtare dhe fetare si dhe personave me origjinë nga i njëjti vend; dhe
- (e) Të zhvillojnë te nxënësi ndjenjën e respektit për mjedisin.

4.2 I gjithë procesi mësimor duhet t'i përshtatet aftësive, prirjeve dhe moshës së secilit nxënësi.

4.3 MASHT mund të nxjerrë udhëzime për të plotësuar qëllimet dhe parimet e përgjithshme të arsimit.

4.4 Theksi vendoset në krijimin e bashkëpunimit të mirë midis nxënësve, prindërve, mësuesve, shkollave, institucioneve formuese dhe vendeve të punës.

4.5 Arsimi i të gjitha niveleve duhet të kujdeset për sigurimin dhe përisimin e mirëqenies mendore dhe fizike të të gjithë nxënësve.

4.6 Të gjithë personat e punësuar në institucionet arsimore të themeluara ose që veprojnë në bazë të këtij Ligji marrin masat e nevojshme në mënyrë që nxënësit të mos lëndohen ose bien viktimë e fjalëve apo veprimeve ofenduese. Ndëshkimi trupor dhe çdo formë tjetër e ndëshkimit poshtërues është e ndaluar në të gjitha institucionet arsimore pavarësisht a financohen nga fondet publike apo private.

4.7 Institucionet arsimore publike do të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose veprimtaritë tjera, të cilat propagandojnë ndonjë fe të caktuar;

4.8 Në sistemin arsimor të Kosovës jepen njohuri të domosdoshme qytetare për formimin e vlerave të denja qytetare.

Në institucionet e arsimit publik është e ndaluar veprimtaria propaganduese në dobi ose në dëm të ndonjë partie politike

## **KAPITULLI II: ORGANIZIMI I ARSIMIT FILLOR DHE TË MESËM**

Neni 5

### **JODISKRIMINIMI**

5.1 Regjistrimi dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë, mundësohet pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë për arsye reale apo të supozuara që kanë lidhje me gjininë, racën, me prirje seksuale, hendikepet fizike, e intelektuale ose hendikepe tjera, gjendjen civile, ngjyrën, religjionin opinionet politike apo të tjera, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti kombëtar, pronësinë, vendlindjen apo rrethanat e tjera të nxënësit ose familjes së tij.

5.2 Arsimitimi i nxënësve me vështirësi në të mësuar trajtohet në Kapitullin 7 të këtij Ligji.

Neni 6

### **ORGANIZIMI I PROGRAMIT ARSIMOR NË KOSOVË**

6.1 Programi i arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në Kosovë, organizohet sipas niveleve të mëposhtëm e të SNKA:

- (a) Niveli 0: Arsimiti parashkollor (normalisht moshat 3 deri në 6 vjet).
- (b) Niveli 1: Arsimiti fillor (faza e parë e arsimit bazë) për 5 vjet (normalisht moshat 6 deri në 12 vjeç).
- (c) Niveli 2: Arsimiti i mesëm i ulët (faza e dytë e arsimit bazë) për 4 vjet (normalisht moshat 12 deri në 15 vjeç); dhe
- (d) Niveli 3: Arsimiti i mesëm i lartë për 3 ose 4 vjet, varësisht nga programet arsimore të përcaktuara nga MASHT (normalisht moshat 15 deri në 19 vjet).

Neni 7

### **ARSIMI I DETYRUAR**

7.1 Shkollimi i detyruar fillon me fillimin e vitit shkollor pasi që fëmija t'i mbushë gjashtë (6) vjet (mosha minimale e arsimit të obliguar.

7.2 Shkollimi i detyruar mbaron me përfundimin e vitit të nëntë të shkollimit nga data e regjistrimit në arsimin fillor ose në datën kur nxënësi i mbush 15 vjet, varësisht se cila nga këto përputhet.

7.3 MASHT mund të nxjerrë udhëzime për të parandaluar anomalitë që mund të lindin lidhur me kërkesat e arsimit të detyruar të përshkruara në pikat 7.1 dhe 7.2.

7.4 Fëmija mund të regjistrohet edhe nën moshën minimale të arsimit të detyruar, në fillim të vitit shkollor, me vlerësim të mjekut dhe të psikologut. Vendimin e merr Drejtoria Komunale e arsimit.

7.5 Shkollat fillore (niveli 1) dhe të mesme të ulta (niveli 2) hapen në çdo komunë. Shkollat në këto nivele mund të kombinohen.

7.6 MASHT, në bashkëpunim me komunat, është përgjegjëse për pajisjen me tekstste mësimore dhe leximi, me pajisje shkrimi dhe vizatimi si dhe me materiale të tjera mësimore të shkollave që janë formuar në përputhje me nenin 7.5.

7.7 Çdo shkollë ka zonën e vet të mbulimit: të gjithë nxënësit e moshës së arsimit të detyruar, që banojnë në atë zonë, kanë të drejtë të regjistrohen dhe të ndjekin shkollën e nivelit përkatës.

7.8 Ndjekja e mësimave në shkollën e caktuar të nivelit përkatës është e detyrueshme për nxënësit e moshës së arsimit të detyruar, me përjashtim kur transferohen në një shkollë tjetër ose përjashtohen nga procesi mësimor sikur është e specifikuar më poshtë në këtë Ligj.

7.9 Në raste të veçanta MASHT mund ta lejojë nxënësin që të mos frekuentojë shkollën e caktuar, sipas pikës 7.8 në qoftë se kjo gjë vërtetohet se është në interesin e nxënësit dhe vetëm me kërkesë të prindërve të nxënësit.

7.10 Prindi (prindërit) i një nxënësi që jeton jashtë zonës së mbulimit të një institucioni arsimor, mund t'i kërkojë komunës përkatëse ta regjistrojë nxënësin në këtë institucion; këto vende caktohen nga komuna në mënyrë të drejtë mbi bazën e kritereve transparente, të bëra publike.

7.11 Prindi (prindërit), i cili është i pakënaqur me procedurën e nxjerrejs së vendimit për kërkesën e bërë, sipas pikës 7.10, ose me arsyet e dhëna në vendimin për këtë kërkesë, mund të ankohet në MASHT, e cila mund t'i kërkojë komunës të rishqyrtojë vendimin e saj.

7.12 Në rrethana të veçanta, kur një gjë e tillë diktohet nga interesat e nxënësve të tjerë, ose kur masat e tjera për të zgjidhur problemin nuk kanë pasur rezultat, Drejtoria komunale e arsimit mund ta transferojë nxënësin nga shkolla e arsimit fillor apo të mesëm të ulët, të cilën ai ka të drejtë të frekuentojë, në një shkollë tjetër. Kjo mund të ndodhë në rastet e mëposhtme:

- (a) Një nxënës mund të transferohet në një shkollë jashtë komunës, kur për të nuk ka vend në shkollën përkatëse në komunë, me përjashtim kur kjo do të kërkonte që nxënësi të shpëtohet nga shtëpia e tij, ose kur rruga nga shkolla në shtëpi dhe anasjelltas, do të bëhej e gjatë;
- (b) Një prind, i cili është i pakënaqur me vendimin e DKA sipas këtij neni ka të drejtë të ankohet në MASHT nëpërmjet Zyrtarit të Lartë të Arsimit

7.13 Kur është e përshtatshme dhe në interes të nxënësit, drejtori i shkollës mbi bazën e një kërkesë nga prindi (prindërit) i nxënësit, mund t'i japë leje për shkëputje nga shkolla deri në dy javë.

7.14 Është shkelje për një prind të një fëmije, të moshës së arsimit të detyruar, në rast se ai:

- (a) Nuk e regjistron fëmijën në një shkollë e cila është shkollë komunale ose shkollë e licencuar private, në përputhje me moshën dhe me nivelin e studimit të fëmijës; ose
- (b) Nuk merr masa për të siguruar që fëmija të ndjekë alternativa të tjera për arsimimin e tij, të cilat janë miratuar nga MASHT.

7.15 Në qoftë se një nxënës mungon në procesin e arsimit të detyruar, prindi (prindërit) i tij mund të detyrohet të paguajë gjoba, po që se mungesa është rezultat i veprimeve të qëllimshme apo neglizhencës së prindit (prindërve). Mund të ngritet padi kundërvajtëse nëse komuna vendos . Në raste të tilla, komuna e njofton MASHT. Ndëshkimet maksimale do të përcaktohen në përputhje me ligjin përkatës.

Neni 8

#### **ARSIMI I MESËM I LARTË**

8.1 Të gjithë nxënësit kanë të drejtë të ndjekin nivelin 3 (arsim i mesëm i lartë) mbi baza vullnetare.

8.2 Pranimi në arsimin e mesëm të lartë bëhet mbi bazën e një sistemi të drejtë përzgjedhës i administruar nga komunat në përputhje me udhëzimet e nxjerra nga MASHT. Pranimi bëhet mbi bazën e një kërkesë të nënshkruar nga nxënësi dhe në kusht që nxënësi të ketë përfunduar me rezultate të kënaqshme programin mësimor të nivelit 2, i cili është i përshtatshëm për studimet në nivelin 3.

8.3 Arsimi profesional në nivelin 3, mund të zhvillohet në shkolla ose në institucione formuese, në ndërmarrje private apo publike. Kushtet në kërkesat e pranimit për programet e arsimit profesional mund të jenë të ndryshme.

8.4 Shkolla ose institucioni formues mundet që, mbi bazën e një kërkesë, të lejojë nxënësin të shtyjë, apo të ndërpresë formimin ose arsimimin e tij.

Neni 9

#### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET SHITESË TË PRINDËRVE**

9.1 Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të sigurojnë që fëmijët e tyre të arsimohen në përputhje me këtë Ligj.

9.2 Prindërit kanë të drejtë të ankohen te mësuesi, pastaj te drejtori i shkollës, te MASHT-i për cilësinë e mësimdhënies. MASHT siguron trajtimin me objektivitet të këtyre ankesave.

9.3 Prindërit kanë të drejtë të ankohen te mësuesi, pastaj te drejtori i shkollës, te Drejtoria Komunale e Arsimit, për ambientet në institucionin arsimor.

9.4 Prindërit kanë të drejtë të marrin pjesë në zgjedhjet për antarët e Këshillit të shkollës në shkollën apo institucionin formues përkatës.

### **KAPITULLI III: PËRGJEGJËSITË E MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TË TEKNOLOGJISË**

Neni 10

#### **PËRGJEGJËSI TË PËRGJITHSHME**

10.1 Në kryerjen e funksioneve dhe të përgjegjësisë të tij mbi bazën e këtij Ligji dhe ligjit përkatës, MASHT:

- (a) Nxiti barazinë në mundësinë për të ndjekur arsimin fillor dhe atë të mesëm, në zhvillimin dhe aftësimin e stafit, dhe në të gjitha aspektet e tjera të arsimit;
- (b) Respekton dhe nxiti të drejtat e komuniteteve dhe antarëve të tyre të përcaktuara në Kapitullin 4 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme; dhe
- (c) Bashkëpunon me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm në ushtrimin e përgjegjësisë të tij ose të saj në bazë të Rezolutës 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për mbrojtjen dhe për nxitjen e të drejtave të njeriut dhe për mbështetjen e veprimtarive që kontribuojnë në forcimin e paqes, si dhe në ushtrimin e autoritetit që i është dhënë atij apo asaj, në bazë të Kapitullit 4, pika 4.6 dhe Kapitullit 8, pika 8.1 (a) e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme.

10.2 MASHT nxjerr udhëzime lidhur me regjistrimin, mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave personale në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, mbi bazën e kritereve të mëposhtme:

- (a) Dokumentet zyrtare të institucioneve arsimore, nuk duhet të përmbajnë të dhëna personale, përveç emrit dhe datëlindjes; dhe
- (b) Të dhënat personale për origjinën etnike apo përkatësinë fetare mund të regjistrohen vetëm për qëllime të vëzhgimit statistikor për të ndihmuar në krijimin e mundësive të barabarta, dhe nuk mund të përdoren për asnjë qëllim tjetër. Këto të dhëna nuk mund të regjistrohen në një mënyrë të tillë që të bëjnë të mundur identifikimin e personit.

10.3 MASHT është përgjegjëse për licencimin e institucioneve arsimore private.

10.4 MASHT paraqet në Kuvend një raport vjetor për arsimin parashkollor, fillor dhe atë të mesëm.

10.5 MASHT kryen të gjitha funksionet e tjera të specifikuar me ligjin e zbatueshëm.

## Neni 11

### **PLANIFIKIMI DHE KOORDINIMI**

11.1 MASHT planifikon dhe koordinon zhvillimin e arsimit parashkollor, fillor dhe atë të mesëm në Kosovë në konsultim me komunat.

11.2 MASHT planifikon dhe krijon strukturën për arsimin e mesëm të lartë (niveli 3), duke marrë parasysh nevojat ekonomike dhe sociale në Kosovë, dëshirat e nxënësve për përparim, dhe nevojat e shoqërisë për arsim të mesëm të lartë në të gjitha fushat studimore dhe për grupmosha të ndryshme, duke marrë parasysh përgjegjësinë e tij për arsim në burgje, në institucionet sociale dhe mjekësore dhe nevojat për arsim special.

11.3 MASHT vendos për themelimin dhe lokacionin për institucionet arsimore të nivelit të mesëm të lartë.

## Neni 12

### **PËRMBAJTJA E ARSIMIT**

12.1 MASHT është përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së arsimit publik, në bashkëpunim me mësuesit dhe ekspertët, në përputhje me qëllimet e shprehura në Nenin 4 të këtij Ligji. Në kryerjen e funksioneve të veta MASHT mbështetet në praktikën më të mirë evropiane dhe botërore.

12.2 MASHT-i nxjerr udhëzimet lidhur me programet mësimore të cilat mësohen në të gjitha nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm duke përfshirë:

- (a) Caktimin e numrit minimal të orëve të mësimdhënies për programin mësimor bazë dhe për programin mësimor bazë të shkollës;
- (b) Metodologjinë themelore dhe programet e lëndëve, objektivat dhe synimet e mësimdhënies për çdo lëndë sipas fazave kryesore të programit mësimor bazë për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. MASHT harton dhe përpunon hollësitë e programit mësimor bazë nëpërmjet një procesi konsultimesh midis tij dhe përfaqësuesve të mësuesve, përfaqësuesve të komunave, dhe ekspertëve arsimorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Këto konsultime realizohen mbi bazën e një mekanizmi që do të përcaktohet nga MASHT; dhe
- (c) Programet shtesë mësimore i miraton MASHT me rekomandimin e Zyrtarit të Lartë të Arsimit të secilës komunë.

12.3 Duke marrë parasysh pikën 3.3 (c), MASHT nxjerr udhëzime jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2003 lidhur me mësimin e gjuhës shqipe nga nxënësit që kanë gjuhë amtare të ndryshme nga Shqipja, si dhe lidhur me mësimin e gjuhëve të tjera të rajonit dhe ato ndërkombëtare.

12.4 MASHT nxjerr udhëzime lidhur më vlerësimin e nxënësve, ankesat kundër vlerësimeve, provimeve dhe certifikatave të shkollave publike dhe private.

12.5 MASHT nxjerr rregulla për kualifikimin e mësuesve, regjistrimin dhe rikualifikimin e tyre në përputhje me ligjin përkatës, duke përfshirë krijimin e një Këshilli shqyrtues të kualifikimit të mësuesve.

12.6 MASHT miraton tekstet shkollore të shkollave publike nëpërmjet një procedure të hapur dhe konkurruese, si dhe krijon një Këshill të Ekspertëve për Tekstet Shkollore, i cili këshillon MASHT-in për këtë çështje.

12.7 Ministria për ASHT përmes institucioneve përkatëse bën kontrollimin profesional të cilësisë mësimore në shkollën fillore e të mesme.

Neni 13

### **RREGULLIMI DHE KONTROLLI**

13.1 MASHT ka përgjegjësi të mbështesë dhe të kontrollojë zbatimin e këtij Ligji dhe udhëzimeve përkatëse nga komunat dhe shkollat.

13.2 Pa paragjykuar përgjegjësitë e veta që rrjedhin nga dispozitat e tjera të këtij Ligji, MASHT gjithashtu:

(a) Nxjerr udhëzimeve për të përcaktuar:

- (i) Kalendar i vitit shkollor, orët e mësimit, pushimet gjatë ditës së mësimit, pushimet shkollore dhe çështje të tjera përkatëse. Koha që i caktohet mësimdhënies nuk është më pak se 37 javë brenda një periudhe kohore prej 45 javësh të njëpasnjëshme gjatë vitit shkollor;
- (ii) Madhësinë maksimale të klasës: udhëzimet mund të jenë të ndryshme, në varësi të faktit nëse nxënësit e një klase i përkasin një apo më shumë grupmoshave. Rastet kur një klasë mund të ketë më tepër se sa numri maksimal i nxënësve mund të miratohen nga Ministria;
- (iii) Kërkesat lidhur me sigurinë e nxënësve.  
dhe

(b) Shqyrton rastet që bëjnë përjashtim dhe ankesat të parashtruara nga komunat, nxënësit, mësuesit, ose prindërit, siç përcaktohen më poshtë në këtë Ligj.

13.3 MASHT kryen kontroll periodik të institucioneve arsimore dhe bën rekomandime për përmisim. Në rastet kur se konstanton shkelje të këtij Ligji ose të udhëzimeve të nxjerra në bazë të tij, MASHT mund të urdhërojë korigjimin e kësaj gjendjeje.

13.4 MASHT merr masa për të siguruar që rekrutimi dhe punësimi i personelit në institucionet arsimore nga komunat të bëhet mbi bazën e kriterëve profesionale ligjit dhe procedurave përkatëse.

13.5 MASHT:

- (a) Cakton dhe punëson një drejtor në çdo shkollë komunale mbi bazën e rekomandimit të një komisioni të përbashkët me përfaqësues të MASHT-it dhe të komunës, i cili formohet me udhëzimin e MASHT-it;
- (b) Punëson mësuesit në institucionet arsimore publike deri sa përgjegjësia për emërimin e mësuesve t'i kalojë komunave, por jo më vonë se 30 qershor 2003.

13.6 Me kërkesë të komunave, MASHT mund t'ua kalojë atyre të drejtën për marrjen e masave arsimore dhe institucionale.

Neni 14

#### **FINANCIMI**

Në bazë të dispozitave të përgjithshme të ligjit të zbatueshëm për financimin e shërbimeve publike në Kosovë, MASHT cakton fondet për komunat në mënyrë që ato të kryejnë funksionet e tyre në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm.

Neni 15

#### **FUNKSIONE TË TJERA TË MINISTRISË SË ARSMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**

15.1 MASHT harton politikën dhe protokolle për arsimimin e personave me nevoja speciale, dhe në veçanti:

- (a) Ndhmon komunat nëpërmjet financimeve shtesë ose me mjete të tjera, në mënyrë që ato të përmbushin detyrimet e tyre ndaj personave me aftësi të kufizuara apo personave të tjerë që kanë nevojë nga dispozita për arsim special;
- (b) Merr masat për përgatitjen e teksteve shkollore dhe mjeteve të tjera arsimore të nevojshme për arsimin special;
- (c) Nxjerr udhëzime për arsimin special.

15.2 MASHT merr masa të posaçme për arsimimin e personave në burgje ose në institucionet e të burgosurve në moshë të re, si dhe për personat e mbyllur në institucione psikiatrike ose që janë shtruar në spital për një kohë të gjatë.

Neni 16

#### **KOMITETI I PRINDËRVEI ARSMIT I KOSOVËS**

16.1 MASHT krijon një Komitet të Prindërve i Arsimit të Kosovës (KPAK). Komiteti ka nëntë(9) anëtarë. Mandati i tyre është katër (4) vjet dhe anëtarët zgjedhin një kryetar dhe një zëvendës kryetar.

16.2 Funkcioni i KPAK është të përfaqësojë interesat e prindërve, t'i përcjellë MASHT mendimet e prindërve për çdo aspekt të arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë si dhe të jetë kanali kryesor i komunikimit midis MASHT dhe prindërve.

16.3 MASHT nxjerr udhëzime lidhur me veprimtarinë e KPAK-së, duke përfshirë procedurat për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve, duke përfshirë pjestarë të komuniteteve të ndryshme.

## **KAPITULLI IV: PËRGJEGJËSITË E KOMUNAVE**

Neni 17

### **PËRGJEGJËSITË E PËRGJITHSHME TË KOMUNAVE**

17.1 Në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të saj në bazë të këtij Ligji dhe ligjit përkatës lidhur me organizimin e arsimit për fëmijët dhe të rriturit në çdo komunë:

- (a) Nxiti barazinë në mundësinë për të ndjekur arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë, në zhvillimin dhe aftësimin e personelit si dhe në të gjitha aspektet e tjera të arsimit; dhe
- (b) Respekton dhe i xiti të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, të sanksionuara në kapitullin 4 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme.

17.2 Komuna nxiti bashkëpunimin midis mësuesve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore dhe midis institucioneve arsimore dhe familjes.

17.3 Të dhënat personale të nxënësve regjistrohen nga komuna në një format të miratuar nga MASHT dhe në harmoni me nenin 10.2 (b) të këtij Ligji.

Neni 18

### **PLANIFIKIMI DHE KOORDINIMI**

18.1 Komuna:

- (a) Bashkëpunon me MASHT në funksionin e saj për planifikimin dhe koordinimin e zhvillimit të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në Kosovë;
- (b) Planifikon zhvillimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë në konsultim me MASHT dhe komunat e tjera.

18.2 Një komunë bashkëpunon me komuna të tjera në projekte të përbashkëta arsimore, në përdorimin e përbashkët të burimeve fizike dhe njerëzore, si dhe në caktimin e fondeve për projekte dhe qëllime të tilla.

Neni 19

### **RREGULLIMI DHE KONTROLI**

19.1 Komuna:

- (a) Në marrëveshje me MASHT, miraton rregullat për themelimin, shkrirjen, ndarjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore me fonde publike të niveleve 0, 1, 2 dhe 3 në komunë;

(b) Rregullon se cila shkolla i përkasin zonave specifike të mbulimit në komunë.

19.2 Komuna është përgjegjëse për:

- (a) Mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucione arsimore me fonde publike si dhe për sigurimin e dispozitave për mirëmbajtje të shërbimeve mbështetëse për mirëqenien fizike të nxënësve, duke përfshirë ujë të freskët, ambiente banjash, dhe shërbime shëndetësore;
- (b) Marrjen e masave për të siguruar që ambienti rrethues urban apo rural, në të cilin është vendosur shkolla, është në përputhje me të drejtën e nxënësve për të pasur një mjedis të sigurt dhe njerëzor jashtë shkollës;
- (c) Nxitjen, në bashkëpunim me MASHT, politikën shoqërore dhe objektivat e shëndetit publik nëpërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, duke përfshirë programe për sigurinë në rrugë, fusha, të nxisë shtimin e shëndetit për të shmangur përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, si dhe aksione kundër duhanit dhe formave të abuzimit me drogë;
- (d) Miratimin e pushimeve lokale të shkollës, në përputhje me ligjin përkatës; dhe
- (e) Miratimin e rregullave të shkollës.

Neni 20

#### **PERSONELI**

20.1 Komuna merr masa për të siguruar që rekrutimi dhe punësimi i personelit në institucionet arsimore të bëhet mbi bazën e kriterëve profesionale dhe ligjit si dhe procedurave përkatëse.

20.2 Komuna është përgjegjëse për:

- (a) Punësimin dhe pagat e personelit të administratës arsimore komunale dhe të personelit administrativ jomësimdhënës të institucioneve arsimore të financuara me fonde publike;
- (b) Punësimin dhe pagat e personelit mësimdhënës në institucionet arsimore duke filluar nga momenti kur MASHT ia kalon komunave përgjegjësinë për punësimin e mësuesve, sipas pikës 13.5 (b) të këtij Ligji;
- (c) Pjesëmarrje në përzgjedhjen e drejtorëve dhe mësuesve që punësohen në shkolla komunale;
- (d) Identifikimin e nevojave dhe realizimin, në bashkëpunim me ZLA për komunë, konkurimin pran trupit përgjegjës për aftësimin në shërbim të drejtorëve dhe mësuesve të shkollave komunale;

- (e) Marrjen e masave për të siguruar përdorimin pa pagesë të ndërtesave dhe ambienteve të shkollave komunale nga mësuesit dhe stafi mbështetës i institucioneve arsimore për qëllime të aftësisë të tyre profesionale, siç përcaktohet në Nenin 28 të këtij Ligji.

#### Neni 21 Financimi

Në bazë të dispozitave të përgjithshme dhe të veçanta të ligjit përkatës për financimin e shërbimeve publike në Kosovë, komuna është përgjegjëse për caktimin e fondeve institucioneve arsimore në komunë dhe për planifikimin dhe adminitrimin e këtyre fondeve në mënyre të efektshme.

#### Neni 22 **TRANSPORTI I NXËNËSVE DHE I MËSIMDHËNËSVE**

22.1 Komuna organizon transport të sigurt dhe të efektshëm për nxënësit që e ndjekin shkollimin e arsimit të detyrueshëm. Ajo mund të vendosë, dhe, sipas dëshirës, të bëjë përjashtime për pagesa lidhur me koston e plotë ekonomike të transportit shkollor për:

- (a) Nxënësit që jetojnë brenda zonës së mbulimit, por brenda distancës prej katër (4) kilometrash nga shkolla, me përjashtim të nxënësve me aftësi të kufizuara;
- (b) Nxënësit që jetojnë jashtë zonës së mbulimit; dhe
- (c) Nxënësit e shkollave të mesme të larta.

22.2 Komuna organizon transport të sigurt dhe të efektshëm për mësimitdhënësit që udhëtojnë nga qyteti në shkolla të fshatrave dhe anasjelltas.

#### Neni 23 **FUNKSIONET E TJERA**

Komuna:

- (a) Merr vendime për ankesat ndaj vendimeve të autoriteteve drejtuese të institucioneve arsimore, siç përcaktohet më poshtë në këtë Ligj;
- (b) Shqyrton vazhdimisht masat e marra për realizimin e arsimit special. Në realizimin e kësaj detyre dhe në atë masë që është e nevojshme ose e dëshirueshme, komuna konsultohet me MASHT dhe komunat e tjera për koordinimin e arsimit të fëmijëve që kanë nevojë për arsim special;
- (c) Bën vlerësime të nevojave speciale, sic përcaktohet më poshtë në këtë Ligj;
- (d) Kryen të gjitha funksionet e tjera të specifikuar në ligjin përkatës.

## **KAPITULLI V: QEVERISJA DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE**

Neni 24

### **DREJTORI**

24.1 Drejtori i një shkolle komunale caktohet sipas procedurës të paraqitur në pikën 13.5(a).

24.2 Personat e emëruar si drejtor duhet të përmbushin kërkesat për kualifikim të përcaktuar në udhëzimet e nxjerra për llojin e shkollës ose nivelet e klasave për të cilat ai është emëruar, dhe personi në fjalë duhet të ketë punuar të paktën tre vjet në procesin edukativo-arsimor.

24.3 Duke iu nënshtruar përgjegjësive të MASHT, komunës dhe Këshillit të Shkollës, drejtori ka përgjegjësinë për administrimin mësimor dhe atë të përgjithshëm të shkollës.

24.4 Drejtori mund të shkarkohet nga MASHT për arsye bindëse të përcaktuara si më poshtë:

- (a) Është dënuar nga gjykata si fajtor për një krim serioz penal;
- (b) Është i paaftë për të kryer funksionet e postit të tij për shkak të paaftësisimit fizik dhe mendor, i vërtetuar nga raporti i një autoriteti të pavarur mjekësor që caktohet nga MASHT;
- (c) Ka bërë veprime që, sipas mendimit të MASHT, përfaqësojnë dështim, ose refuzim, neglizhim apo paaftësi të vazhdueshme për të kryer detyrat e postit ose për të realizuar objektivat e arsimit që paraqiten në nenin 4.

24.5 Ankesa ndaj vendimit të MASHT për të shkarkuar një drejtor, sipas dispozitave të kësaj pjese, paraqitet në gjykatën e juridiksionit përkatës.

24.6 Drejtori është i obliguar të paraqes një raport vjetor për veprimtarinë e shkollës dhe të jep informacionë të tilla sa herë që kërkohet nga komuna, MASHT ose Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

24.7 Drejtori cakton një zëvendës, i cili merr funksionet e tij kur ai/ajo mungon. Shkolla mund të ketë zëvendësdrejtor. Kriteret për krijimin e vendit të punës për zëvendësdrejtor i përcakton MASHT-i në bashkëpunim me komunat.

Neni 25

### **ZYRTARI I LARTË I ARSIMIT**

25.1 MASHT emëron një zyrtar të lartë arsimor për çdo komunë ose 2 e më tepër komuna, varësisht nga nevoja.

25.2 Funkzioni i Zyrtarit të Lartë i Arsimit është të ushtrojë përgjegjësitë e tij mbi bazën e këtij Ligji si dhe ato përgjegjësi të MASHT-it, të cilat MASHT vendos t'ia caktojë zyrtarit të lartë të arsimit.

Neni 26

#### **DREJTORI I ARSIMIT KOMUNAL**

26.1 Çdo komunë cakton një drejtor të arsimit komunal.

26.2 Funkzioni i çdo drejtori të arsimit komunal në çdo komunë është të ushtrojë përgjegjësitë e tij mbi bazën e këtij Ligji si dhe ato përgjegjësi të komunës, të cilat komuna vendos t'ia caktojë drejtorit të arsimit komunal.

26.3 Kryenëpunësi ekzekutiv i komunës, duke vepruar nëpërmjet drejtorit të arsimit komunal, është përgjegjës për menaxhimin efikas të efektshëm dhe ekonomik të të gjitha burimeve lidhur me detyrimet dhe përgjegjësitë e komunës për institucionet arsimore në komunë.

26.4 Në ato raste kur, në bazë të këtij Ligji, një element i përgjegjësisë financiare i është deleguar Këshillit të shkollës ose drejtorit, përgjegjësitë e kryenëpunësit ekzekutiv, nëpërmjet drejtorit të arsimit komunal, janë të kufizuara në marrjen e masave për të siguruar që kjo përgjegjësi financiare t'i nënshtrohet kontrollit njëloj si përgjegjësitë e tjera të ushtruara nga komuna.

Neni 27

#### **MOSDISKRIMINI NË EMËRIMET**

Të gjitha emërimet të bëra në bazë të pjesëve 24, 25, dhe 26 bëhen në bazë të meritës personale, pas një njoftimi publik, pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë për arsye reale apo të supozuara që kanë lidhje me gjininë, racën, priirjen seksuale, gjendjen civile, ngjyrën, fenë, opinionet politike apo të tjera, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti kombëtar, pronësinë, vendlindjen apo rrethanat e tjera.

Neni 28

#### **KUALIFIKIMI I PERSONAVE TË EMËRUAR**

28.1 Të gjithë personat e emëruar si drejtor shkolle ose drejtor i arsimit komunal dhe çdo person tjetër me përgjegjësi për administrimin e institucioneve arsimore, duhet të ketë përfunduar me sukses deri në 31 dhjetor 2003 një program kualifikimi për udhëheqje dhe administrim, i cili duhet të jetë i autorizuar nga MASHT.

28.2 Duke filluar nga 1 qershor 2005 të gjithë kandidatët për postet e përmendura në pjesët 24, 25, dhe 26 duhet të kenë përfunduar me sukses përpara emërimit të tyre një program kualifikimi për udhëheqje dhe administrim, i cili duhet të jetë autorizuar nga MASHT.

**KËSHILLAT E SHKOLLAVE**

29.1 Çdo institucion arsimor me fonde publike ka një Këshill të shkollës. Në rast se Këshilli i shkollës nuk krijohet dot ose nuk arrin të mbledhet për një periudhë prej tre muajsh, funksionet e tij i kalojnë drejtorit të shkollës, me kusht që të paktën një herë në vit të bëhen përpjekje të tjera për të krijuar Këshillin dhe për ta mbledhur atë.

29.2 Përbërja e këshillit të shkollës:

- (a) 3 përfaqësues të prindërve;
- (b) 5 përfaqësues të mësuesve të shkollës;
- (c) Në rastin e shkollave të niveleve 2 dhe 3 (të mesme), 1 përfaqësues i nxënësve të zgjedhur nga dhe ndër nxënësit e asaj shkolle.

29.3 Zgjedhja e antarëve të Këshillit të Shkollës bëhet me votim të fshehtë.

29.4 Këshilli i shkollës ka të drejtë të kooptojë përfaqësues të tjerë pa të drejtë votimi, në mënyrë që të sigurojë që në Këshill të përfaqësohen të gjitha komunitetet që kanë numër të konsiderueshëm të nxënësve në shkollë, punonjësit, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë së gjerë, duke përfshirë, në rastet kur është e mundur, përfaqësues të Zyrës së Komunitetit, e krijuar në bazë të pikës 23.11 të Rregullores Nr. 2000/45 të UNMIK-ut.

29.5 Anëtarët e Këshillit të shkollës kanë mandat tre-vjeçar, me kusht që të vazhdojnë të jenë prindër të nxënësve, mësues, ose nxënës të shkollës, sipas rastit. Përfaqësuesit e prindërve dhe mësuesve mund të zgjidhen apo kooptohen për një mandat të dytë.

29.6 Kryetari i Këshillit të Shkollës zgjidhet çdo vit nga Këshilli nga radhët e përfaqësuesve të prindërve. Ai mund të rizgjidhet.

29.7 Drejtori i shkollës është Sekretari i Këshillit të Shkollës. Drejtori i raporton Këshillit, sipas kërkesës, për aktivitetet dhe financat e shkollës dhe ka të drejtë të propozojë zgjidhje dhe të marrë pjesë në debat, por nuk ka të drejtë vote.

29.8 Këshilli i Shkollës mund të ftojë drejtorin e arsimit komunal, ose zëvendësit e tyre, për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të shkollës për të dhënë informacion apo sqarime ose për të dëgjuar mendimet e Këshillit.

29.9 Këshilli i Shkollës ka të drejtë:

- (a) Të hartojë rregullat e shkollës, të cilat i paraqiten për miratim komunës;
- (b) Të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një përfaqësues të mësuesve për të marrë pjesë në emërimin e drejtorit dhe mësuesve në shkollë sipas procedurave të përcaktuara në këtë Ligj dhe në udhëzimet e nxjerra në bazë të tij ligjin përkatës;
- (c) Të vendosë për caktimin e fondeve me kontribut nga prindërit dhe për fonde të tjera të siguruar jashtë buxhetit të shkollës; dhe

(d) Të vendosë për veprimtaritë jashtëshkollore.

29.10 Këshilli i shkollës mban dokumentacionin e duhur për të gjitha paratë e marra dhe të shpenzuara dhe ia dorëzon atë procedurave të kontrollit që zbatohen në komunë.

29.11 Përveç kësaj, Këshilli i shkollës konsultohet për çështjet e mëposhtme:

- (a) Zhvillimin fizik të shkollës;
- (b) Çështje të programit shtesë mësimor sipas shkollave;
- (c) Reagimet e komunës për çfardo dokumenti politik apo konsultativ që lidhet me arsimin në Kosovë;
- (d) Datat e pushimeve të vendit [shkollore];

dhe mund të shprehë pikëpamjet e veta për çdo çështje lidhur me shkollën, ose me arsimin fillor apo të mesëm në komunë.

Neni 30

#### **KËSHILLAT E NXËNËSVE**

30.1 Çdo shkollë krijon Këshillin e nxënësve, i cili përbëhet nga të paktën një nxënës nga çdo klasë, i zgjedhur me votim të fshehtë, për të gjitha shkollat e nivelit 2 ose 3.

30.2 Funkzioni i Këshillit të nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës, dhe interesave që kanë të bëjnë me mirëqenien e nxënësve, si dhe t'i paraqesin këto probleme te drejtori dhe te Këshilli i shkollës.

Neni 31

#### **RREGULLAT E SHKOLLËS**

31.1 Çdo komunë miraton rregullat ("rregullat e shkollës") për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve në cdo institucion arsimor, pasi ka marrë me parë propozimet e Këshillit të Shkollës dhe komentet e drejtorit për këto rregulla.

31.2 Në rregullat e shkollës përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e nxënësve që nuk janë parashikuar në këtë Ligj, në udhëzimet e nxjerra në bazë të saj ose në ligjin përkatës. Ato përfshijnë rregullat për sjelljen dhe specifikojnë procedurat dhe masat që do të merren ndaj nxënësve që i thyjnë rregullat. Këto procedura ose masa mund të përfshijnë:

- (a) Humbjen e përkohshme të mundësisë për të marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore pasi më parë nxënësit i është bërë një paralajmërim; dhe
- (b) Qortimin formal të nxënësit dhe prindërit (prindërve).

31.3 Rregullat e shkollës botohen dhe afishohen në një vend të dukshëm në çdo shkollë dhe një kopje i jepet çdo nxënësi kur ai regjistrohet. Po kështu, çdo nxënës informohet për

çdo ndryshim në rregullat e shkollës. Njoftimi i nxënësit konsiderohet si njoftim për prindërit. Rregullat e shkollës shpallen në gjuhën e nxënësve të cilët vijojnë atë shkollë.

31.4 Drejtori ka përgjegjësi kryesore për të siguruar zbatimin e rregullave të shkollës dhe për trajtimin me drejtësi dhe barazi të çdo rasti të shkeljes së tyre. Kjo detyrë mund t'i delegohet zëvendësit të tij. Asnjë masë nuk mund të merret ndaj një nxënësi në qoftë se nxënësit nuk i jepet mundësia të paraqesë me gojë mendimin e tij para personit të ngarkuar me trajtimin e problemit. Në rastin e shkeljeve serioze të rregullave nga nxënësit e niveleve 1 dhe 2, duhet t'i jepet mundësia edhe prindit (prindërve) të paraqesë mendimin e tij.

31.5 Në rastin e sjelljes së dhunshme apo agresive, e cila nuk lejon vazhdimin e procesit mësimor për nxënësit e tjerë, Drejtori ose zëvendësi i tij, mund të urdhërojë largimin e përkohshëm të tij nga ora e mësimin apo nga shkolla për 3 ditë. Pezullimi për më tepër se 3 ditë deri në një muaj bëhet me pëlqimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit. Është detyra e drejtorit komunal të Arsimit të ndërmjetësojë për rikthimin e nxënësit në shkollë. Të drejtën për të pezulluar një nxënës për një periudhë më të gjatë se një muaj e ka vetëm komuna, e cila ka gjithashtu për detyrë të organizojë arsimimin alternativ të nxënësit.

## **KAPITULLI VI: PERSONELI**

Neni 32

### **KUALIFIKIMI DHE EMËRIMI I PERSONELIT**

32.1 Personat e riemëruar mësimdhënës në arsimin fillor dhe të mesëm kanë kualifikimet përkatëse profesionale dhe arsimore të miratuara nga Këshilli Shqyrtues i Kualifikimit të Mësimdhënësve i themeluar në bazë të pikës 12.5 të këtij Ligji ose deri sa të themelohet Këshilli nga MASHT.

32.2 Të gjithë mësimdhënësit duhet t'i nënshtrohen rikualifikimit dhe zhvillimit përkatës profesional sipas kërkeses së MASHT. I gjithë personeli i shkollës, duke përfshirë stafin mbështetës dhe administrativ, duhet t'i nënshtrohet kualifikimit që do t'u afrohet pa shpëputje nga puna.

32.3 MASHT nxjerr udhëzime lidhur me emërimin, mbajtjen në punë, përparimin në profesion, disiplinën, largimin nga puna dhe daljen në pension të mësimdhënësve, parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e barazisë, duke përfshirë pagë të barabartë për punë të barabartë midis burrave dhe grave. Këto udhëzime janë në përputhje me këtë Ligj dhe ligjin e zbatueshëm për administratën shtetërore. Në rastet kur ka mospërputhje midis ligjit përkatës për administratën shtetërore dhe këtij ligji, ky Ligj merr përparësi.

32.4 Të gjitha vendet e lira shpallen publikisht:

- (a) Nga MASHT në rastin e vendeve për drejtor shkollë dhe mësimdhënës;
- (b) Nga komuna në rastin e personelit tjetër.

32.5 Si MASHT ashtu dhe komuna, si struktura që bëjnë emërimet, zbatojnë një procedurë të drejtë, të hapur dhe transparente për emërimet mbi bazën e kualifikimeve, përvojës së

kandidatëve dhe kërkesave të postit. Drejtorët e shkollave marrin pjesë në emërimin e mësimit në shkollat e tyre.

32.6 Kur bëhet zgjedhja midis dy apo më shumë kandidatëve për një vend mësimit, theksi vihet në nivelin arsimor, përvojën, kërkesat për postin si dhe nevojat për mësimit që do të plotësojë ky emërim. Në rast se asnjë kandidat nuk plotëson kërkesat për kualifikim të përcaktuar në këtë Ligj, mund të bëhet një emërim i përkohshëm. Emërimet e tilla përfundojnë në ditën e fundit të vitit shkollor gjatë të cilit u bë emërimi.

32.7 Komunitetet u sigurojnë mësimit stazhierë kushte për kualifikim dhe stazh praktik në institucionet arsimore, në përputhje me vendimet e MASHT-it.

32.8 Asnjë person nuk mund të emërohet në një post mësimit në qoftë se, ai është dënuar më parë për një krim dhunë apo veprime të padenja me apo që prekin fëmijët. Një person i dënuar për një krim të tillë shkarkohet nga posti i tij ose i saj në përputhje me ligjin përkatës. Kur një prej anëtarëve të stafit është nën hetime penale për përdorim dhune ose veprime të padenja me ose që përfshijnë fëmijët, ai ose ajo duhet që të pezullohet nga puna me pagesë deri në përfundim të hetimeve.

Neni 33

#### **MBROJTJA NDAJ SANKSIONEVE ARBITRARE**

33.1 MASHT dhe komunitetet u japin mësimit lirinë, brenda ligjit dhe në përputhje me nivelin e arsimit ku janë punësuar, për të venë në pikëpyetje dhe diskutim opinionet ekzistuese si dhe për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme ose jo-popullore brenda programit të miratuar arsimor, pa rrezikuar humbjen e vendit të punës ose të drejtat që mund të kenë.

33.2 E drejta e mësimit për lirinë e fjalës mund të kufizohet vetëm me ligj.

33.3 MASHT dhe komunitetet marrin masa të sigurojnë që:

- (a) Mësimit të kenë lirinë e organizimit dhe tubimit sipas ligjit;
- (b) Personeli të jetë i mbrojtur nga diskriminimi i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë për arsye reale apo të supozuara që kanë lidhje me gjininë, racën, prirje seksuale, gjendjen civile, ngjyrën, fenë, opinionet politike apo të tjera, origjinën kombëtare, etnike apo sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti kombëtar, pronësinë, vendlindjen apo rrethanave të tjera si dhe personat me dëmtime fizike dhe mendore.

33.4 Mësimit dhe personeli tjetër i institucioneve arsimore kanë të drejtë të kundërshtojnë në gjykatën e juridiksionit përkatës çdo vendim apo veprim të komunës ose MASHT lidhur më ta.

33.5 MASHT nxjerr udhëzime që përcaktojnë rrethanat në të cilat një mësimit mund të marrë punësim shtesë të paguar apo papaguar dhe që kufizojnë përgjegjësinë ligjore të punëdhënësit në raste të tilla.

Neni 34

#### **MARRËVESHJET KOLEKTIVE LIDHUR ME PAGAT DHE KUSHTET E PUNËS**

Për postet që mbulohen nga ky Ligj, pagat dhe kushtet e punësimit caktohen në përputhje me ligjin përkatës për administratën shtetërore, e cila i nënshtrohet nenit 32.2 të këtij Ligji. Për çështje që kanë të bëjnë me kushtet e punës në institucionet arsimore, MASHT konsultohet me Sindikatën e Arsimit dhe Shkencës së Kosovës dhe çdo sindikatë tjetër që përfaqëson kategoritë përkatëse të punonjësve.

### **KAPITULLI VII: NEVOJAT SPECIALE**

Neni 35

#### **E DREJTA PËR ARSIM SPECIAL**

35.1 Nxënësit që nuk përfitojnë ose që nuk kanë mundësi të përfitojnë mësimdhënie të zakonshme në mënyrë të kënaqshme kanë të drejtë për arsim special dhe është detyra e komunës ta sigurojë këtë arsim në bazë të dispozitave të këtij Ligji dhe brenda kufijve të buxhetit komunal.

35.2 Në vlerësimin së çfarë lloj mësimdhënie speciale do të jepet i kushtohet vëmendje e veçantë mundësive të individit për zhvillim.

35.3 Përmbajtja e kurseve të ofruara për arsim special është e tillë që individit të përfitojë në mënyrë të përshtatshme nga mësimdhënia në përputhje me objektivat arsimorë të realizueshme nga ai apo ajo. Individët që përfitojnë arsim special kanë të njëjtin numër total të orëve mësimore si nxënësit e tjerë.

Neni 36

#### **PROCEDURAT ADMINISTRATIVE PËR VENDIMET MBI ARSIMIN SPECIAL**

36.1 Me kërkesë të nxënësit ose prindit të nxënësit, komuna bën verifikimet e nevojshme për të përcaktuar nëse ekziston nevoja për arsim special për nxënësin dhe, nëse po, çfarë lloj mësimdhënie nevojitet.

36.2 Personeli mësimdhënës në një institucion arsimor shqyrton nëse ndonjë nga nxënësit në këtë institucion ka nevojë për arsim special dhe, nëse po, njofton për këtë drejtorin e shkollës.

36.3 Arsimi special planifikohet në bashkëpunim me prindin (prindërit) e nxënësit, dhe, për aq sa është e mundur, me nxënësin. Mendimeve të tyre u kushtohet vëmendje.

Neni 37

#### **VLERËSIMI PROFESIONAL**

37.1 Përpara se komuna të marrë vendim për arsim special për një nxënë, bëhet një vlerësim profesional i nevojave specifike të këtij nxënësi. Ky vlerësim përcakton nëse nxënësi ka nevojë për arsim special dhe se çfarë lloj mësimdhënie duhet t'i jepet.

37.2 Vlerësimi profesional, që përshkruhet në nenin 37.1, shqyrton dhe përcakton çështjet e mëposhtme:

- (a) Nëse nxënësi mund të përfitojë nga mësimdhënia e zakonshme;
- (b) Vështirësitë e nxënësit për të mësuar dhe kushte të tjera të veçanta me rëndësi për mësimdhënien;
- (c) Synime të përshtashtme arsimore për nxënësin; dhe
- (d) Çfarë lloj mësimdhënie është e përshtatshme, dhe nëse është e mundur të jepet ndihmë për vështirësitë në kuadër të dispozitave të zakonshme të arsimit.

37.3 Në rast se vendimi i komunës ndryshon nga vlerësimi profesional, arsyet për vendimin e komunës shpjegohen me shkrim. Vendimi përfundimtar në raste të tilla merret nga MASHT.

Neni 38

#### **PËRMBAJTJA E MËSIMDHËNIES**

38.1 Në rastin e arsimit special, dispozitat në këtë Ligj dhe dokumentet plotësuese të nxjerra në bazë të këtij ligji lidhur me përmbajtjen e mësimdhënies zbatohen në atë masë që ato janë të aplikueshme. Për nxënësit që marrin arsim special përgatiten programe mësimore individuale. Në këto programe përshkruhen synimet dhe përmbajtja arsimore si dhe mënyra e realizimit të mësimdhënies.

38.2 Çdo semester mësimdhënësi i klasës përgatit një raport përmbledhës me shkrim për mësimin e përfituar nga nxënësi që merr arsim special si dhe bën një vlerësim për ecurinë e nxënësit. Drejtori ua dërgon këtë përmbledhje dhe vlerësim si dhe vëzhgimet e tij apo të saj për këtë ecuri prindërit (prindërve) të nxënësit.

Neni 39

#### **SHËRBIMI KËSHILLIMOR DHE SHËNDETËSOR PËR NEVOJAT SPECIALE**

39.1 Çdo komunë themelon vetë ose në bashkëpunim me komunat e tjera një shërbim këshillimor arsimor dhe psikologjik. Shërbimi këshillimor arsimor dhe psikologjik në një komunë ka funksionet e mëposhtme:

- (a) Ndihmon institucionet arsimore në komunë (komunat) të zhvillojnë kapacitetin e specializuar për të përmisuar përshtatjen e mësimdhënies në institucione ndaj nxënësve me nevoja speciale; dhe
- (b) Përgatit vlerësime profesionale sa herë që kjo kërkohet në bazë të këtij Ligji.

39.2 MASHT mund të nxjerrë udhëzime për kontrollin dhe ndihmën mjekësore për nxënësit që marrin arsim special.

Neni 40

#### **MËSIMDHËNIA NË GJUHËN E SHENJAVE DHE SIS TEMIN BRAILLE**

40.1 Nxënësit dhe fëmijët nën moshën e arsimit të detyruar, të cilët përdorin gjuhën me shenja si gjuhë të tyre të parë, duhet të marrin, për aq sa është e mundur, mësim për përdorimin e gjuhës së shenjave si dhe lëndët mësimore nëpërmjet gjuhës së shenjave.

40.2 MASHT mund të vendosë që mësimdhënia nëpërmjet gjuhës së shenjave dhe për përdorimin e gjuhës së shenjave të zhvillohet në një vend të ndryshëm nga shkolla ku nxënësi do të duhej të ndiqte mësimet normalisht.

40.3 Nxënësit më shikim të pjesshëm dhe nxënësit e verbër kanë të drejtë për mësimdhënie për përdorimin e gjuhës Braille dhe për mjetet e nevojshme teknike. Nxënës të tillë kanë gjithashtu të drejtën për orientimin e nevojshëm dhe për udhëzime gjatë lëvizjeve në shkollë, vajtjen dhe kthimin nga shkolla, dhe në shtëpi.

40.4 Përpara së të merren vendime për dhënien e mësimin në gjuhën e shenjave, në gjuhën Braille, ose për orientimin dhe lëvizje, shërbimi këshillimor dhe shëndetësor i komunës, i krijuar në bazë të nenit 39, bën një vlerësim profesional.

### **KAPITULLI VIII: ARSIMI PRIVAT**

Neni 41

#### **SHËRBIMET ARSIMORE PRIVATE**

41.1 Çdo institucion arsimor privat i çdo niveli në programin e arsimit fillor dhe të mesëm që funksionon në Kosovë kërkon marrjen e licensës nga MASHT.

41.2 Kriteret për dhënien e një licence formulohen nga MASHT dhe përbëjnë një standard zyrtar të licencimit, i cili publikohet.

41.3 Standardi licencues i MASHT merr parasysh shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies dhe të mësuarit të përdorura nga institucionet private, si dhe kërkon plotësimin e kushteve lidhur me:

- (a) Përshtatshmërinë e ndërtesave dhe pajisjeve, duke përfshirë klasat për mësim, kabinete, punëtoritë dhe laboratorët;
- (b) Ambiente për biblioteka dhe kompjuter;
- (c) Numrin e duhur dhe kualifikimet e duhura të personelit;
- (d) Ambientet për nxënësit; dhe
- (e) Plan programin bazë mësimor.

41.4 Një institucion arsimor privat mund të fillojë funksionimin vetëm pasi të ketë marrë një licencë, por mund të reklamojë për të tërhequr nxënës dhe të rekrutojë nxënës gjatë periudhës së dhënies së licencës.

41.5 Licenca i jepet çdo institucioni i cili plotëson kriteret.

41.6 Një kusht për dhënien e licencës një institucioni arsimor privat është paraqitja MASHT-it i një plani biznesi për institucionin, duke përfshirë një garanci nga themeluesi i këtij institucioni për gjendjen e qendrueshme financiare për të paktën tre vjet. Ky plan rishikohet vazhdimisht, ndërsa garancia financiare i paraqitet MASHT çdo vit.

41.7 Një institucion arsimor privat mund t'i kërkojë MASHT në çfarëdo lloj kohe ndryshimin e kushteve në licencën e tij.

41.8 Një institucion arsimor privat mund që, në bazë të kontratës më prindërit, të përcaktojë rregullat e sjelljes për nxënësit.

41.9 Një institucion arsimor privat mund të mbyllet nga themeluesi i tij vetëm në përfundim të vitit shkollor. Licenca për një institucion arsimor privat përfshin një dispozitë për angazhimin e këtij institucioni për të mbrojtur interesat financiare të nxënësve, të cilët, në rast të mbylljes së institucionit, do të kenë nevojë të përfundojnë arsimimin e tyre në një institucion tjetër.

41.10 MASHT mund të nxjerrë udhëzime lidhur me dhënien e shërbimeve arsimore private apo mbështetjes për shërbimet arsimore private nga ana e organizatave apo operatorëve joqeveritare me qëllim që ky aktivitet të zhvillohet në përputhje me këtë Ligj.

## **KAPITULLI IX: DISPOZITAT E PËRKOHSHME DHE PËRMBYLLËSE**

Neni 42

### **ZBATIMI**

42.1 Ministri për MASHT nxjerr udhëzime administrative për zbatimin e këtij Ligji në harmoni me Kornizën Kushtetuese.

42.2 Struktura e sistemit arsimor e përcaktuar me nenin 6 do të zbatohet për klasën e nëntë (9), përkatësisht për vitin orientues kalimtar duke filluar nga viti shkollor 2002/2003.

Neni 43

### **LIGJI I APLIKUESHËM**

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji pushojnë së vlejture ligjet e mëparshme të cilat kanë rregulluar këtë lëmi.

Neni 44

### **HYRJA NË FUQI**

Ky Ligj duhet hyrë në fuqi më 31 tetor 2002.

***Akademik Nexhat Daci***  
***Kryetari i Kuvendit të Kosovës***

## SHTOJCA 1

Përkufizimi i “ISCED” i përmendur në Nenin 1 të këtij Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë

Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit 1997 (ISCED)

Sistemi i klasifikimit të standardeve për arsimin, i hartuar nga UNESCO, synon të lehtësojë krahasimet midis statistikave dhe treguesve arsimore të vendeve të ndryshme mbi bazën e përkufizimeve të njëjta dhe të pranuar ndërkombëtarisht.

ISCED paraqet koncepte, përkufizime dhe klasifikime standarde. Ai është një kuadër që ndihmon për hartimin dhe paraqitjen e statistikave dhe treguesve arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai mbulon të gjitha veprimtaritë e organizuara dhe të vazhdueshme mësimore për fëmijët, të rinjtë, dhe të rriturit, duke përfshirë edhe ata që kanë nevojë për arsim special. Duke shërbyer si një bazë e shëndoshë për krahasime statistikore midis sistemeve të ndryshme arsimore, ISCED do të ndihmojë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë hartuesit e politikave arsimore dhe të tjerët, të cilët duan të mësojnë nga përvoja e zhvillimit të arsimit të vendeve të tjera.

ISCED është një sistem shumë funksional i hartuar për të ndihmuar në bërjen e analizave dhe marrjen e vendimeve, pavarësisht nga struktura e sistemeve arsimore kombëtare dhe faza e zhvillimit ekonomik të një vendi. Ai mund të shfrytëzohet për qëllime statistikore për aspekte të ndryshme të arsimit si frekuentimi i shkollës, burimet njerëzore ose financiare të investuara në arsim, ose niveli arsimor i popullsisë. Për këtë arsye, konceptet dhe përkufizimet bazë të ISCED janë hartuar në një mënyrë të tillë që të jenë të vlefshme për të gjithë, pavarësisht nga rrethanat specifike të sistemeve arsimore në vende të ndryshme.

Shihni më poshtë një tabelë që përmbledh nivelet:

**PËRMBLEDHJE E NIVELEVE ARSIMORE ISCED**  
(burimi: UNESCO)

Si përcaktohet niveli i një programi		Emri i nivelit	Kodi	Dimensionet plotësuese
Kritere model për përmbajtjet				
Kriteret kryesore	Kriteret plotësuese			
Karakteristikat arsimore Me bazë shkolle apo qendre Moshë minimale Kufiri i moshës më të madhe	Kualifikimi i personelit	Arsimi parashkollor	0	Asnjë
Fillimi i procesit sistematik të të mësuarit për të lexuar, shkruar dhe për matematikën	Regjistrimi në institucionet dhe programet fillore në shkallë kombëtare Fillimi i arsimit të detyruar	Arsimi fillor Faza e parë e arsimit bazë	1	Asnjë
Paraqitja e lëndëve Aplikimi i shprehive bazë dhe hedhja e bazave për të mësuar gjatë gjithë jetës	Regjistrimi pas afro 6 vitesh në arsim fillor Përfundimi i ciklit pas 9 vitesh që nga fillimi i arsimit fillor Përfundimi i arsimit të detyruar Shumë mësues japin mësim në fushat e tyre specifike	Arsimi i mesëm i ulët Faza e dytë e arsimit bazë	2	Lloji ose destinacioni i arsimit që vijon Orientimi i programit
Kualifikimi tipik për pranim Kërkesa minimale për pranim		Arsimi i mesëm (i lartë)	3	Lloji i arsimit ose destinacionit që vijon Orientimi i programit Vazhdimësia kumulative që nga fillimi i nivelit ISCED 3
Kërkesa për pranim, Përmbajtja, Moshë, Kohëzgjatja		Arsimi joterciar, pas arsimit të mesëm	4	Lloji i arsimit ose destinacionit që vijon Kohëzgjatja kumulative që nga fillimi i nivelit ISCED 3 Orientimi i programit
Kërkesa minimale për pranim, Lloji i certifikatës që është marrë, Kohëzgjatja Përmbajtja me orientim nga kërkimi shkencor, Paraqitja e tezës ose disertacionit	Përgatitja e të diplomuarve për poste në fakultete dhe për kërkime shkencore	Faza e parë e arsimit terciar (që nuk con direkt në një kualifikim për kërkime të avancuara) Faza e dytë e arsimit terciar (që con në një kualifikim për kërkime të avancuara)	5 6	Lloji i programeve Kohëzgjatja teorike kumulative në terciar Struktura kombëtare e titujve dhe kualifikimeve Asnjë